

## MBAHET NË UASHINGTON DIALOGU I PARTNERITETIT STRATEGJIK SHQIPËRI-SHBA

Shqipëria dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës rikonfirmojnë partneritetin strategjik dhe angazhohen për të vijuar bashkëpunimin me interes të përbashkët në fusha si: mbrojtja, siguria kibernetike, energjia, transporti apo tregëtia. Kjo ka qenë garancia e dhënë nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Olta Xhaçka dhe Sekretari Amerikan i Shtetit, Antony Blinken në përfundim të dialogut të partneritetit strategjik.

## RAPORTI I KE KONFIRMON AVANCIMIN E RRUGËTIMIT EVROPIAN TË SHQIPËRISË

Ministrja Xhaçka theksoi se Raporti i Progresit për Shqipërinë për vitin 2022 nga Komisioni Evropian konfirmon se Shqipëria ka vazhduar të përmbushë të gjitha kushtet e përcaktuara në Konkluzionet e Këshillit të Marsit 2020. Në mbledhjen e Këshillit Kombëtar për Integrimin Evropian, Ministrja Xhaçka theksoi se raporti njih punën e madhe që është bërë dhe konfirmon progresin e Shqipërisë në rrugëtimin e saj drejt integritimit evropian.

## PROCESI I BERLINIT, XHAÇKA: THELBËSOR RIVITALIZIMI I KËTIJ PROCESI

MEPJ Olta Xhaçka mori pjesë në takimin e Ministrave të Jashtëm në kuadër të Procesit të Berlinit, ku theksoi se Shqipëria e konsideron këtë proces si një shtysë për të çuar përpara axhendën e BE-së në tre shtylla kryesore: rritja ekonomike dhe ndërlidhja, marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe bashkëpunimi rajonal, si dhe zhvillimi i shoqërisë civile dhe lidhja ndërmjet njerëzve. Ajo vlerësoi konsensusin e arritur për nënshkrimin e tre marrëveshjeve në fushën e lëvizjes së lirë në rajon.

## MBLIDHET NË TIRANË GRUPI INFORMAL I PUNËS TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT TË OKB

MEPJ Olta Xhaçka, mirëpriti në Tiranë Grupin Informal të Punës të Këshillit të Sigurimit të OKB, për Dokumentacionin dhe Çështjet e Tjera Procedurale (IWG). Për 2 ditë me rradhë përfaqësues zyrtarë të vendeve anëtare të Këshillit të Sigurimit, studiues të përzgjedhur dhe përfaqësues nga Divizioni i Çështjeve të Këshillit të Sigurimit (SCAD) u mbledhën në Tiranë për të ndarë idetë, pozicionet dhe mendimet mbi avancimin e metodave të punës së Këshillit.

## SHQIPËRI-KANADA, FUQIZIM I DIALOGUT POLITIK TË NIVELIT TË LARTË

MEPJ Olta Xhaçka, zhvilloi një takim me Kryetarin e Kuvendit të Kanadasë, Anthony Rota. Ministrja Xhaçka vlerësoi mbështetjen e Kanadasë ndaj vendit tonë, duke e cilësuar atë një mike të çmuar dhe partnere të vlefshme për Shqipërinë. Ministrja Xhaçka dhe Anthony Rota u dakordësuan për avancimin e mëtejshëm të bashkëpunimit Shqipëri-Kanada, në fusha të reja nga të cilat do të përfitojnë njerëzit e dy vendeve.

## SHQIPËRIA MBËSHTET NISMAT QË SYNOJNË T'I JAPIN FUND AKTEVE KRIMINALE NË IRAN

MEPJ Olta Xhaçka, mori pjesë në takimin Ministre të Jashtëm të organizuar nga Ministria e Jashtëm e Kanadasë, Melanie Joly, mbi shkeljen e të drejtave të njeriut në Republikën Islamike të Iranit. Ministrja Xhaçka vlerësoi homologen kanadeze për iniciativën e ndërmarrë, ndërsa theksoi se Shqipëria qëndron përkrah popullit iranian, i cili po lufton për të ruajtur të drejtat e tij më elementare njerëzore.

